
GJON BUZUKU



Revistë informative, kulturore e shoqërore
Ulqin, e enjte më 7 prill 2016 Çmimi 1€
numër 46



fq. 2



Foto më 1910, në Ulqin; Mësuesi Mitar Iveliq me 44 nxënës (meshkuj e femra), ndër këta 2 harapë (zezakë, çka e vërteton që fotografia u bë në Ulqin); 7 nxënës meshkuj kanë qeleshe në krye, çka dëshmon që edhe ulqinakët e kishin traditë të mbulonin kryet me qeleshe (plis).

fq. 17

Koncert i SHA "Tradita" me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës

Shpalosen vlerat e folklorit mbarëshqiptar

Shoqëria Artistike "Tradita" pas një aktiviteti të suksesshëm trevjeçar arriti të organizojë koncertin premierë, ku shpalosi pjesët më të rëndësishme të programit të vet.

Më 17 shkurt 2016, në Qendrën e Kulturës – Ulqin, SHA "Tradita" para publikut të këtij qyteti arriti të prezantonte vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore.

Në koncertin premierë të SHA "Tradita" morën pjesë Ansambli "Ilirida" – Shkup, Ansambli "Dëshmorët e Kombit" - Obiliq dhe Folk Grupi "Bilbili" - Vlorë.

SHA "Tradita" u prezantua me pjesë të programit të shfaqur në Festivalin Folklorik Mbarëkombetar të Gjirokastrës, ku u performua Vallja e burrave të Anës së Malit, e cila në koncertin premierë të SHA "Tradita" u interpretua së bashku me valltaret e Ansamblit "Dëshmorët e Kombit" – Obiliq, Këngën e Gjergjefit të interpretuar nga Egzona Salaj, fituese e Çmimit të Parë në Festivalin Mbarëkombëtar të Gjirokastrës, kolazhin e punuar prej pjesëve të zgjedhura të valleve që "Tradita" ka realizuar në aktivitetin e vet trevjeçar, ku shquhet Vallja e Xhemiles, vallja e mirënjohur autoktone e Anës së Malit. Kënga qytetare e Ulqinit u soll nga këngëtari i mirënjohur Suad Mehmeti.

Në koncertin premierë u prezantua dhe këngëtari Edmir Lika, si dhe u interpretua kënga autoktone e trevës sonë, e titulluar "Shegë e amël", e realizuar në valle nga trupa e SHA "Tradita".

Ansambli "Ilirida" nga Shkupi u prezantua me Vallen Kosovare dhe Vallen e Rajces.

Folk grupi "Bilbili" nga Vlora u paraqit përpara publikut të Ulqinit me vallen me motive çame, e njohur ndryshe si Vallja e Osman Takës, pastaj me një këngë polifonike kushtuar Ismail Qemalit dhe vallen e kënduar "Një komb, një flamur".

Ansambli "Dëshmorët e Kombit" nga Obiliqi, i cili mori pjesë në Vallen e burrave të Anës së Malit, me të cilën u hap koncerti premierë i SHA "Tradita", u prezantua edhe me dy valle.

"Ilirida" nga Shkupi, "Bilbili" nga Vlora, "Dëshmorët e Kombit" nga Kosova dhe organizatori i këtij koncerti "Tradita", si një ansambël i vetëm uruan Pavarësinë e Kosovës, ku vend të veçantë në këtë urim zunë momentet e interpretuara prej prezantueseve dhe moderatorit të shfaqjes Shefqet Luca, si dhe kënga "Ti ma gëzofsh Kosovë lirinë", e interpretuar nga këngëtari i mirënjohur Gëzim Salaj.

Koncerti i SHA "Tradita" u mbyll me vallen premierë, të titulluar "Vallja e bashkimit", e cila u interpretua nga trupa e SHA "Tradita".

Me praninë e kryesisë së SHA "Tradita" dhe trupave të ansambleve pjesëmarrëse, u shpall që "Tradita" të krijohet Ansambël.

Në koncertin premierë të SHA "Tradita" nderuan me pjesëmarrjen e tyre Shkëlqesia e saj Ambasadorja e SHBA-ve në Mal të Zi, znj. Margaret Uyehara, Zv. Ambasadori i SHBA-së, z. Bix Aliu me përfaqësues të trupës diplomatike, Shkëlqesia e tij Ambasadori i Shqipërisë në Mal të Zi, z. Ernal Filo, Sekretarja e parë e Ambasadës së Shqipërisë znj. Mimoza Veroshi, si dhe mjaft personalitete nga fusha të ndryshme, miq dhe të ftuar të tjerë, si dhe donatorët të cilët i dhanë përkrahje financiare aktivitetit trevjeçar të SHA "Tradita".

Pas koncertit premierë, në hotelin "Mediteran" u organizua një darkë solemne me të gjitha ansamblet dhe mysafirët e ftuar, ku dhe u ndanë mirënjohjet nga kryetari i BKA-së, Kabil Kurti, dhe kryetari i SHA "Tradita", Selatin Gjeloshi. **(SH. A. "Tradita")**



PËRMBAJTJA

2. Shpalosen vlerat e folklorit mbarëshqiptar
3. Nji hadet i shestanasve
4. Dita e Flamurit bashkon shqiptarët
5. U mbajt edicioni i IV i Maratonës së Pavarësisë
6. Nderi i Akademisë dhe Mirënjohja e Ulqinit
7. Libër kritik me qëllim ndërgjegjësimi
8. Libri për Tivarrin i Hajro Ulqinakut
9. Fotografi Bernard Beni Hasanaj
10. Shpërngulja si obsesion i shqiptarëve në MZ
11. Një vepër e rëndësishme e Stipçeviqit
12. Pod of Ljare - Arbanas of Zadar
14. Katedralja e Shnjonit në Shas
15. Xhamia e Meterizit - (sot kisha ortodokse)
16. Revistë e hapur për të gjithë krijuesit
17. Një libër për bibliotekën e Ulqinit
18. Po vjen një poet
19. Fotografia si pasion
20. Rrugëtimit të mërgimtarëve tonë në Amerikë
21. Rrok Gjonlleshaj - arqipeshkv i ri në Tivar
22. Donatorët rinovuan kishën Shën Ndou në Braticë
23. Pjetër Dreshaj model i arsimdhënies
24. Fituesit e çmimit *Pena e Flakës*



REVISTË INFORMATIVE, KULTURORE E SHOQËRORE

Kryeredaktor:
Prof. dr. Simë Gjon Dobreci

Ndihmës i kryeredaktorit
Gjekë Gjonaj

Anëtarët e redaksisë:
Dr Martin Berishaj, Dr Nail Draga, Msc Anton Lulgjuraj, Prim.dr. Gani Karamanaga, Dr. Zylfije Duraku, Luigj Camaj, Anton Pllumaj, Gjokë Dabaj, Hajro Ulqinaku, Ali Gjeçbritaj, Muzafer Çaushi, Mustafa Canka

Fotoshërbimi:
Foto Studio Ars, Foto Rozafa, Foto Arb, Art Foto Prishtinë, Foto Bruno
Realizimi artistik:
Fisnik Dobreci & Gazmend Çitaku

Adresa e redaksisë:
Braticë
85360 ULQIN
Nr.tel. ++382 (0) 30 401-384, 069 441-943
www.buzuku.info
E-mail: fdobreci@t-com.me

Numri i llogarisë rrjedhëse
Banka komerciale malazeze A.D.
Ekspozitura Ulqin Nr. 510-0-40
Thirrje ne Nr. 510270393491001825

Me vendimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme të Malit të Zi, Podgoricë, nr.05-006/12-20622/2, revista e regjistruar në nr. 6308, më 13.02.2014

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Nji hadet i shestanasve

S'di se ku e kam shënue, por ktu po e përsëris. Ka mot baba* me tregoi që shestanasit kanë bajtë qeleshen (plisin) e bardhë të pshtjellun me shami të zezë dhe çakshirët e bardhe me shirita të zí. Kur e pyeta për arsyen, ai m'u përgjigj: "Si m'kanë thanë pleqtë, me kta shenja të zí Shestanasit kanë majtë jazë/zí për Gjergj Kastriotin Skenderbegun"

*Gjoni (6.1.1899-21.10.1977) Niksë Kol'Niksë Pjetër Gjonit Gjergj Gjonaj/Dobreci, shestanas, Bratica, Ulqin.

Një kangë historike

Grupi i parë i të parëve të Arbanasve në Zadar (arbëreshët në Zarë, Dalmaci, Kroaci) erdhi më 1726 prej Shestanit, Pinçit, Ljares dhe Briskut (pjesa perëndimore e Krajës, jug-perëndimi i Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit, Mali i Zi). Pata rastin të njoftohem me 3 kangët e Arbanasit për Gjergj Kastriotin- Skënderbeun, të cilat me siguri që u barten prej Shestanit dhe u ruajtën në Arbanasi (Arbëresh) të Zadrës (Zarës) në Kroaci. Njëra prej tyre është **Atje larg**, e cila ka vlerë të madhe historike. Ajo vërteton që shestanasit, të gjithë kranjanët, jo vetëm e kanë përkrahur Skënderbeun, por edhe kanë marrë pjesë në beteja, ku shumë prej tyre kanë mbetur në fushë të luftës, aty *"ku po kalben djelm te ri"*, si thuhet në këtë kangë. Kangët për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, Shestanasit i harruan, por e vërteta është që, për Skënderbeun dhe fatkeqësitë e asaj kohe, ata nuk harruan të mbanin zí me shaminë e zezë të pështjellur rreth qeleshes së bardhë dhe me shirita të zí në çakçirët e bardhë. Edhe në mungesë të fakteve, duhet të besohet që Skënderbeu ka pasur luftëtarë vullnetarë edhe prej trevës së Ulqinit, Tivarit e Shkodrës (që ishin në atë kohë nën Venedikun), pastaj prej Malësisë, Zetës (Mali i Zi i sotëm), si dhe prej shumë territoreve tjera jo vetëm të atyre shqiptare. Përndryshe, do të ishte e pamundur, që 25 vjet t'i bëhej ballë sulmeve të pandërprera turke, e cila ishte një mbretëri në ekspansion dhe atëherë shumë e fuqishme.

Përgatiti **Simë Gjon Dobreci** *Botuar në* Buzuku 34, 2010:3

Atje larg

(Kangë historike - e ruajtën në Arbanasi, Zadër)

Atje larg ne fuš te molit[1]
Ku po kan dek djelm te ri
Ej te ri, te ri, te ri, te Skenderbeu
Atje larg ku po kalben djelm te ri
Nana kjojet[2] per šupnies[3] mikešave soj[4]
Per bic[5] ciš[6] i ka bir[7] ne luft
Ej te ri, te ri, te ri, te Skenderbeu
Ej te ri, te ri, te ri, te Skenderbeu

1.ne fuš te molit - ?në fushë të madhe (të luftës); **2.**kjojet - (u) qahet (u kjahet); **3.**šupnies – Shqipërisë; **4.**soj – sajë (sâjë); **5.**bic – birtë, bijtë, djemtë (djeltë); **6.**ciš – (qi) që; **7.**bir – bjerrë, humb (c=ç, š=sh).

*Marrë prej FEJA/VJERA nr 1 (List Zadarskih Arbanasa, prigodno izdanje 10.XII.2005, povodom obilježavanja 280 godina dolaska Arbanasa u Zadar (1726-2006) – Gazetë e arbëreshëve të Zarës, e botuar më 10.XII.2005, për të shënuar 280 vjetorin e ardhjes së arbëreshëve në Zarë (1726-2006). Shih edhe BUZUKU 20/2006:3.

O etje e mallkuar e florinit, ku nuk e shtynë ti shpirtin e njeriut?
(Virgjili, Eneida, Toena/Tiranë, 1996:80)

Dita e Flamurit bashkon shqiptarët

Shkruan **Ismet Kallaba**

Me manifestimin e organizuar më 28 Nëntor 2015, në sallën e mbushur plot të Qendrës së Kulturës në Ulqin, ku morën pjesë këngëtarë të muzikës të lehtë dhe popullore, aktorë, valltarë, nxënës etj. nga Ulqini, Shkodra dhe Tirana, Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve në Malin e Zi shënoi në Ulqin 28 Nëntorin – Ditën e Flamurit Kombëtar dhe Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë.

Manifestimi filloi me intonimin e himnit kombëtar nga sopranoja Gjylie Pelingu, nën përcjelljen e korit të fëmijëve.

Në fjalën përshëndetëse, kryetari i KKSH-së, Genc Nimanbegu, ka thënë se 28 Nëntori është festa që i bashkon shqiptarët anembanë botës, "festa që shqiptarët i bën një".

Duke folur për të kaluarën e popullit shqiptar, ai ka thënë se duhet t'i kujtojmë me nderim dhe të ndjehemi krenarë për veprat e të parëve tanë.

"Si komb i lashtë dhe krenar, t'i kujtojmë të parët tanë që jetuan në kushte më të vështira se ne dhe prapëseprapë e ruajtën gjuhën, kulturën, traditën e lashtë shqiptare dhe Flamurin tonë kuq e zi, të cilit të gjithë i përulemi dhe e kemi në zemër", ka thënë Nimanbegu, duke porositur se megjithatë, "shikimi ynë duhet të jetë i drejtuar nga e ardhmja sepse ne e meritojmë atë më të mirë, më të begatë dhe më të lumtur".

Ai ka folur më pas për aktivitetin e KKSH-së gjatë këtij viti, duke thënë se është përqendruar kryesisht në çështjet dhe problemet e arsimit shqip në Mal të Zi.



Nimanbegu ka paralajmëruar se KKSH do të hapë së shpejti zyrat në Plavë dhe në Tuz, në mënyrë që të jetë e pranishme në të gjitha trevat ku jetojnë shqiptarët dhe të kontribuojë në zgjidhjen më të shpejtë të problemeve të tyre.

Sipas tij, sfidat e shqiptarëve në Mal të Zi janë të shumta.

Kryetari i KKSH-së ka thënë se "duhet bërë shumë që popullsia jonë të mos asimilohet dhe për këtë do të punohet posaçërisht në periudhën e ardhshme".

Ndërsa duke folur për shqiptarët që jetojnë në shtetet ballkanike, Nimanbegu ka thënë se sfida e tyre kryesore është "implementimi i vlerave evropiane në jetën e përditshme", e cila do të ndikojë që "të gjitha qëllimet tona politike, ekonomike, kulturore etj. të jenë më lehtë të realizueshme".

Në programin artistik kanë marrë pjesë ndër të tjerë aktorja e njohur Roza Anagnosti, këngëtarja Myfarete Laze, grupi i valleve të Qendrës Kulturore Kombëtare për Fëmijë nga Tirana, SHKA "Zana", këngëtari vendas Nexhat Kaleziqi, këngëtaret e reja Eliza Markiqi dhe Xhenana Lanica, nxënësi Behar Pali dhe artiste të tjerë, nën moderimin e aktores dhe regjisores Alma Memo – Hoti dhe poetit Pjaver Kroni.

Në mesin e të pranishmëve ishin





ministrja Marija Vuçinoviq, deputetë, kryetari i Këshillit Kombëtar Kroat, Zvonimir Dekoviq, konsulli i Shqipërisë, Janko Selçaj, zyrtarë të Komunës së Ulqinit, drejtori i Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, Safet Kurtagiq, aktori i njohur Alfred Trebicka, maratonistë pjesëmarrës në Maratonën e Pavarësisë Shkodër – Ulqin, personalitete nga fusha të tjera dhe qytetarë.

U mbajt edicioni i katërt i Maratonës së Pavarësisë Triumfon maratonisti shqiptar Ilir Këllezi

Për nder të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit dhe të Pavarësisë së Shqipërisë, është mbajtur edicioni i katërt i Maratonës së Pavarësisë, në relacionin Shkodër – Ulqin.

Në të kanë marrë pjesë 32 maratonistë nga Mali i Zi, Shqipëria, Kosova, Franca, SHBA etj., në mesin e të cilëve për herë të parë edhe dy femra.

Fitues u shpall maratonisti nga Korça, Ilir Këllezi. Vendi i dytë i takoi maratonistit nga Tivari, Dragoljub Koprivica, fitues i dy edicioneve të mëparshme, ndërsa vendin e tretë e zuri Emin Grajçevci nga Kosova.

Për fituesit e tre çmimeve të para janë ndarë shpërblime nga Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve në Malin e Zi, ndërsa të gjithë pjesëmarrësve u janë ndarë çertifikata.



Maratona Shkodër – Ulqin është organizuar nga KKSH, Komuna e Ulqinit dhe Bashkia Shkodër.

Atdhe, o ti Ilion, banesë hyjnish, ju ledhet e **dardanëve** që fituat gjithë atë nam në sa e sa beteja!
(Virgjili, Eneida, Toena/Tiranë, 1996:50)

***

Një zanore që i mungon alfabetit shqyp

Zanorja **ö (oe;** si gjermanisht te fjala *schön*) përdoret në pak fjalë ndër shqyptarë shestanas, psh: **Vö, vötë** vezë pule; **vösë, vösa** – ves, ujë, lagështi që ngjitet për barë në mëngjes; **vösë, vösat** – vojsë/vojsat, pemë frytore e pyllit; **pilivösë** pilivesa, kandërr; **böthë** – bythë, prapanica; Fushae **Böthkanit** – toponim në perëndim të mbarimit të malit Marvjan.

Imperativi (urdhërorja) i fjalëve me zanoren **ö** *(***oe)** përdoret ndër shestanas shumë shpesh, por vetëm në formën njëjës (singular):

Punö – punoje, **livrö** tokën – livroje tokën, **marö** punën, **latö** gurin, **lexö** librin, **shikö** atë, **paströ** penxheren, **qirö** mollën, **lirö** rrugën... (theksi në **ö**).

Simboli i gjarprit në ENEIDA

(Marrë nga **Virgjili** 70-19 para Krishtit, **Eneida**, Toena/Tiranë, 1996:135)

Nga kjo pamje u shtang Eneu në vend;
gjarpri mbas një gjarpërimi shumë të gjatë,
gjithnjë duke u zvarritur përmes enëve
dhe kupave të lëmuara,
në fund zuri e shijoi dhuratat edhe prapë,
pa prekur njeri, ai vajti dhe u tërhoq
në fund të varrit, duke i lënë altarët,
ku dhe gëlltiti ushqimet.
Pastaj Eneu e nis sërish dhe më me zjarr
ceremoninë e flijimit në nderim të prindit të vet,
pa qenë krejt i sigurt
a do ta quante atë **gjarpër** një **mbrojtës** të vendit,
apo të shpirtit familjar të prindit të vet.

***

SHESTANASIT, si dhe shumë Shqiptarë tjera, thonë 'gjarpni ruen shpinë'

“Nderi i Akademisë” dhe “Mirënjohja e Ulqinit”



Në një ceremoni solemne të organizuar më 14.10.2015 në hotelin “Meditaran” në Ulqin, në prani të familjarëve, miqve dhe personaliteteve nga jeta shkencore, kulturore, politike etj., Akademia e Shkencave e Shqipërisë i ka dhënë prof. Dr. Ruzhdi Ushakut medaljen “Nderi i Akademisë”, ndërsa Kuvendi i Komunës së Ulqinit titullin “Mirënjohja e Ulqinit.

Kryetari i Akademisë, prof. Dr. Muzafar Korkuti, ka thënë se “**Akademia e Shkencave të Shqipërisë e vlerësoi punën shkencore të prof. Dr. Ruzhdi Ushakut me medaljen 'Nderi i Akademisë', me motivacion 'për kontribut të veçantë në kërkime e trajtime gjuhësore krahasuese, mbi bazë burimesh epigrafike dorëshkrimesh të lashta, për kontribut të gjatë pedagogjik, si dhe për përkushtimin e vazhdueshëm në evidentimin e vlerave historike, etnografike dhe turistike të qytetit të Ulqinit**”.

Kryetari i Akademisë së Shkencave e ka vlerësuar prof. Ushakun, duke e cilësuar atë “një figurë të shquar të shkencës së Ulqinit dhe shqiptarëve në Mal të Zi, por edhe të albanologjisë”.

Medalja “Nderi i Akademisë” i është dorëzuar prof. Dr. Ruzhdi Ushakut nga sekretari shkencor i Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike të Akademisë së Shkencave, akademiku Jorgo Bulo.

Mbi veprimtarinë dhe të arriturat shkencore të prof. Dr. Ruzhdi Ushaku ka folur studiuesi nga Kosova prof. Dr. Begzad Baliu. Ai tha “Fati i profesor Ruzhdi Ushakut, vepra e të cilit sot po kurorëzohet me një vlerësim akademik, paraqet një botë të pasur, aq sa edhe komplekse, të këtij rindërtimi historik dhe kërkues”.

Bashkëkohaniku dhe bashkëvendasi i prof. Dr. Ruzhdi Ushakut, publicisti dhe shkrimtari Ali Llunji ka thënë se me punën e vet 50-vjeçare, me vullnet të pashoq, ai e ka dëshmuar veten si krijues.

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi, Genci Nimanbegu, ka thënë se ndonëse prof. Dr. Ruzhdi Ushaku ka jetuar dhe vepruar në trevat tjera, vendlindja për të ka qenë dhe mbetet shumë e rëndësishme.

Në fjalën e tij, akademiku Zuvdija Hoxhiq ka folur me superlativa për prof. Dr. Ruzhdi Ushakun, si njeri dhe studiues.

Titullin “Mirënjohja e Ulqinit” ia ka dorëzuar prof. Dr. Ruzhdi Ushakut kryetari i Kuvendit të Komunës së Ulqinit, mr. Fuad Haxhibeti.

Ai ka thënë se Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2014, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Këshillit për dhënien e propozimeve të emërtimeve të rrugëve, shesheve dhe institucioneve, vendosi t'i japë titullin “Mirënjohja e Ulqinit” prof. Dr. Ruzhdi Ushakut, me motivacionin “për kontribut në fushën e arsimit, studimeve filologjike dhe botimeve shkencore me vlerë kombëtare dhe ndërkombëtare”.

Laureati i medaljes “Nderi i Akademisë”, prof. Dr. Ruzhdi Ushaku, ka thënë se këtë çmim prestigjoz që i jepet nga institucioni më i lartë shkencor shqiptar, e përjeton si krenari dhe obligim të veçantë.

Ndërkaq duke folur për titullin “Mirënjohja e Ulqinit”, Ushaku ka thënë se rruga e tij jetësore dhe formimi profesional kanë synuar, në rend të parë, për t'i shërbyer arsimit dhe kulturës në vendlindje.

Takimi solemn është organizuar nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Komunën e Ulqinit, Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi, Qendrën e Kulturës – Ulqin, Shoqatën e Artistëve dhe Intelektualëve “Art Club”, Fondacionin “Lika” dhe Bashkimin e Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi.

Marrë prej* **Ismet Kallaba: “Nderi i Akademisë” dhe “Mirënjohja e Ulqinit”, **Koha javore**, nr 685, 22 tetor 2015:10-11.



Libër kritik me qëllim ndërgjegjësimi

Shkruan **Gjekë Gjonaj**

Në Katërkollë të Anës së Malit, më 4 shkurt 2016 u bë përurimi i librit ”VITET E HUMBURA” të autorit anamalas Shaban Peraj. Në prani të një numri shumë të madh të dashamirëseve të librit, në një atmosferë të ngrohtë dhe të bukur për librin e z. Peraj folën dr. Nail Draga dhe gazetari i njohur Gjekë Gjonaj.

Gazetari Gjonaj duke folur për autorin e këtij libri z. Peraj u shpreh se autori në mes politikës dhe mos-heshtjes për problemet që i shqetësojnë shqiptarët në Mal të Zi, zgjodhi këtë të dytën, mos-heshtjen. Shaban Peraj, i cili tash disa vjet është shkëputur nga politika aktive dhe ka zgjedhur një rrugë më pak të leverdishme, rrugën e mos-heshtjes dhe të kritikës ndaj politikës. Me opinionet dhe analizat e tij kryesisht nga jeta politike e shqiptarëve nëpër revista, gazeta dhe portale të ndryshme shqiptare në Mal të Zi, Kosovë, Shqipëri dhe në diasporë, ka krijuar imazhin e një analisti me të drejtë fjale, që nuk është politikan por që merret me politikën. Këtë konstatim timin e dëshmon libri i tij i dytë me titull ”VITET E HUMBURA”. Analisti Shaban Peraj në këtë libër publicistik me artikuj, komente, opinione, reagime, intervista etj., shpreh opinionet, pikëpamjet, mendimet, idetë, vlerësimet dhe qëndrimet e tij kryesisht për politikën shqiptare gjatë 25 viteve të fundit të pluralizmit politik, të cilat autori me të drejtë i vlerëson vite të humbura të periudhës së tranzicionit, u shpreh Gjonaj.

Redaktor i librit, dr. Nail Draga, vlerësoi se libri VITET E HUMBURA, me çështjet e trajtuara, qasjen dhe analizën e autorit, paraqet një kontribut më vlerë në publicistikën analitike tek ne dhe më gjerë. ”Te gjithë ata të cilët në të ardhmen do të trajtojnë çështjet përkatëse nga kjo periudhë kohore të pluralizmit, patjetër duhet ta kenë si referencë edhe këtë botim. Duke e marrë parasysh se është nder librat e rrallë të kësaj natyre tek ne, ai është i mirë se ardhur jo vetëm për një profil të veçantë lexuesish, por edhe për opinion e gjerë”, pohoi Draga



Në fund të mbrëmjes publikut të shumtë iu drejtua edhe vetë autori, ndërsa profesoresha Nepe Peraj, përndryshe bashkëshortja e autorit, mjeshtërisht recitoi një poezi të shkrimtarit të madh Esad Mekuli.

Libri ”VITET E HUMBURA” është libri i dytë i Shaban Peraj.

Recenzent i librit është Ali Salaj, lektor Hajrullah Hajra ndërsa redaktor teknik Gazmend Çitaku.

Në fund të këtij përurimi autori dhuroi nga një kopje të librit për të gjithë të pranishmit.

LIBRI PËR TIVARRIN i Hajro Ulqinakut

Në Galerinë e Arteve të Qendrës së Kulturës – Ulqin, më 19.12.2915 u përurua ”Libri për Tivarrin“, i shkrimtarii Hajro Ulqinaku.

Libri i botuar nga Shoqata “Art Club“ i kushtohet Masakrës së Tivarit 70-vite më parë. Në libër përfshihen këngë popullore, balada, poezi, poema, tregime, monodrama, dëshmi të dëshmitarëve, letër e hapur, studime etj. të autorëve nga të gjitha trevat shqiptare.



Kryetari i SHAI „Art Club“, Ali Salaj, ka thënë në fjalën përshëndetëse se Masakra e Tivarit deri para pak vitesh ka qenë temë tabu për të cilën flitej fare pak e edhe më pak shkruhej. Në kohën e fundit është riaktualizuar kjo çështje, siç shihet edhe këtë libër.

Hajredin Kovaçi ka thënë “Ulqini ka ngritur zërin edhe më parë për këtë ngjarje, poetët kanë thurur vargje, poema, është mbajtur Konferencë shkencore, janë çuar kurora me lule në vendin e ngjarjes, janë bërë përurime librash, etj. dhe vjen **ky libër si një thirrje, klithje, por as për së afërmi me atë të të rënëve, sepse as poetët më të shquar, as shkrimtarët më të mirë nuk mund ta përshkruajnë dot me fjalë atë çfarë ka ndodhur në Tivar, madje as dëshmitarët që mbijetuan në këtë ngjarje makabre, në këtë tragjedi që s'u zbardh kurrë**.

“Duke lexuar librin të bie në sy se shumë poetë në poezitë e tyre përmendin ullirin si një bimë që duron shumë, që është simbol i qëndresës, që jeton gjatë, por që është dëshmitar dhe mbase një ditë do të flasë dhe do të rrëfejë atë çka ka parë e dëgjuar”, është shprehur Kovaçi, i cili për të pranishmit ka recituar poezinë “Shtatëdhjetë vjet më parë”.

Gjokë Dabaj tha “Kam qenë shtatë vjeç kur e kam përjetuar për herë të parë atë tragjedi, të pakundshoqe në marrëdhëniet midis kombit shqiptar dhe kombeve të tjerë reth e rrotull”, ka thënë Dabaj, i cili ka treguar se gjatë shtegtimit me bagëti nga Krytha e Ulqinit drejt bjeshkëve të Shestanit, bashkë me nënën e tij, kishin takuar disa shqiptarë nga Kosova, që i kishin shpëtuar masakrës.

“Ky ka qenë përjetimi im i parë i asaj tragjedie dhe nuk më është hequr kurrë nga përfytyrimi”, ka vazhduar rrëfimin e tij ai.

Dabaj ka treguar se poema e tij “Tivar-Tivar”, kushtuar Masakrës së Tivarit, u krijua në vitin 1968 kur Kosova vlonte nga demonstratat. Më pas, ajo është ripunuar disa herë për të marrë formën e sotme me titullin “Prush plagësh të pambyllura”.

Ibrahim Berjashi ka treguar përvojën dhe kërkimet e tij lidhur me Masakrën e Tivarit.

Ai ka thënë se derisa ishte nxënës në Ferizaj është ballafaquar me vështrimet e vëngërta të bashkëmoshatarëve të tij kur u ka treguar se është nga Komuna e Tivarit, pa e kuptuar shkakun e vërtetë. Sipas tij, Masakra e Tivarit është një enigmë që duhet të zbulohet.

Sipas Haxhi Shabanit, është me rëndësi të shkruhet në mënyrë të paanshme një histori e shqiptarëve në Malin e Zi, përfshirë edhe Masakrën e Tivarit.

“Kjo është me rëndësi të dorës së parë. Dhe këtë mendoj që edhe ne si shqiptarë të Malit të Zi duhet ta bëjmë, së paku duhet ta artikulojmë, ta nisim këtë problem”, është shprehur ai dhe më pas ka lexuar për pjesëmarrësit në përurim poezinë e tij “Tivarvarri”.

Aktori Shefqet Luca ka recituar poemën “Viktimave të Tivarit”, të shkruar nga Mustafë Shyti, dëshmori i rënë në luftën e fundit në Kosovë në vitin 1998, familjarët e të cilit ishin të pranishëm në përurim, dhe nxënësja Nejra Mujali ka recituar poezinë e Jaho Kollarit kushtuar Masakrës së Tivarit.

Përurimi është organizuar nga Shoqata e Artistëve dhe Intelektualëve “Art Club”.

*Marrë nga shkrimi i Imet Kallabës të botuar në KOHA JAVORE nr 694, 24 dhjetor, fq 16-17.

Fotografi Bernard Beni Hasanaj



Intervistoi **Don Gabriel Grabanica**

Kam lindë në Gjakovë, Republikën e Kosovës.
Kam jetuar 6 vite në Kosovë dhe mandej jemi shpërngulë familjarisht në Tuz, Malësi nën Malin e Zi ku edhe jetoj tani.
Kam mbaruar shkollën e mesme në Tuz Gjimnazin 25 Maji.
Mbas shkollës së mesme kam punuar si kamarier në restorante të ndryshme, mandej kam punuar si menaxher në disa firma.
Sa i përket profesionit tim si fotograf kam filluar që në vitin 2010 si hobi, mandej regjistrova dhe mbarova kursin e fotografisë në Podgoricë. Momentalisht punoj në ndërmarrjen Triticum në Tuz si administrator, përveç kësaj merrem edhe me fotografi.
Jam arkatar, fotograf dhe anëtar i bordit të OJQ LABEATËT, shoqatë kjo e cila merret me trashëgimin kulturo historike të Malësisë së Madhe.
Fotograf personal i shoqërisë kulturo artistike ANSAMBLI SHQIPONJA, Sekretar i klubit të Taekwondo Alba.



Nga puna ime që kam bëre deri tani si fotograf, kam fotografuar trevat e Malësisë së Madhe, Dhe nuk ka pjesë e malësisë që nuk është e fokusuar nga optika e aparatit tim. Jam fotograf në manifestime të ndryshme, si në darsma, mbrëmje mature, fotografi për reklama të ndryshme. Por edhe pse jetojë në trevën e Malesisë syrit tim nuk i ka mungua as Shestanit, Ulqinit, fshatra dhe qytete në bregdet. Duke filluar nga Herceg Novi e deri në lumin Buna. Optika e aparatit tim ka fokusuar edhe veshjet kombëtare të ruajtura me shumë fisnikëri në trevat shqiptare në veçanti veshjet e malësorëve dhe veshjet e shestanaasve. Kjo përvojë e ka shtua në mua zellin për të vazhduar aktivitetin tim në këtë fushë, pa të cilën jam i bindur së do të isha shumë i varfër shpirtërisht pa të. **Fotografia është pjesë e bukur e jetës time.**
Falë dashurisë për fotografinë, dhe falë bukurisë natyrore dhe njerëzore që kanë këto treva çdo ditë e me shumë shtohet vullneti që sa më shumë ky vend të jetë në arkivin tim fotografik.
Kohëve të fundit jam edhe fotograf zyrtar edhe për ansamblin Trendafilat e Shen Terezës në Ulqin, fotograf në aktivitetet e shumta që organizohen nga Kisha Katolike në Braticë. Si dhe pjesë e revistës Buzuku më kryeredaktor Dr. Simë Dobreci.



[1] Me nenjë n'dy ose n'tri karriga (popullore) është *njësoj si* [2] m'u bâ masha e tjetër-kuj (popullore), *ose si* [3] m'u bâ mish i shitun (arbëneshe, Zadër, Kroacia).

GJON BUZUKU 46

Shpërngulja si obsesion i shqiptarëve në Mal të Zi

Shkuan **Ismet Kallaba**

Ulqin – Në sallën e konferencave të Hotelit "Mediteran", më 29.01.2016, u shfaq premiera e filmit dokumentar "NDËRMJET", kushtuar shqiptarëve në Mal të Zi, me skenar dhe regji të Haxhi Shabanit, shkrimtar dhe gazetar i Redaksisë Shqipe në Televizionin e Malit të Zi.



Filmi trajton temën e shpërnguljes së shqiptarëve në Malin e Zi, si një dukuri shumëvjeçare e cila vazhdon të jetë edhe sot aktuale. Një vend i veçantë në filmin "Ndërmjet" u kushtohet problemeve identitare të shqiptarëve, siç janë problemet e ruajtjes së gjuhës, kulturës etj., sikurse edhe problemet e integrimit të tyre. Në film është gërshetuar edhe një pjesë që përmbledh në formë artistike domosdoshmërinë e ringjalljes së vlerave identitare të shqiptarëve në Malin e Zi.

Kritiku i filmit Ali Salaj ka thënë se që në sekuencat e para, me shfaqjen e dyerve të mbyllura të shtëpive, filmi na sugjeron gjendjen aktuale të shqiptarëve në Mal të Zi, këtij komuniteti i cili dita-ditës po shpërngulet duke e rrudhur hapësirën e vet etnike.

"Përmes opinioneve të njohësve të mirë të fushave të ndryshme, imazhi për shqiptarët në Malin e Zi bëhet më dramatik dhe prodhon shqetësime të mëdha për të ardhmen e këtij komuniteti", ka theksuar ai.

Salaj ka thënë se autori vë në dukje se një çerek shekulli pas sistemit monist, shqiptarët gjithnjë e më shumë po asgjësohen si një pakicë që dikur ishte faktor në Malin e Zi dhe se ky asgjësim po ndodh në të gjitha fushat e veprimtarisë: në art, kulturë, informim, politikë etj.

Sipas tij, autori i filmit ravijëzon identitetin e dyzuar të shqiptarëve në Mal të Zi, duke e krahasuar në mënyrë simbolike me sanduiçin.

"Për këtë arsye filmi edhe titullohet 'Ndërmjet', që do të thotë diçka e gjendur në mes dy a më shumë vetave ose sendeve. Të tillë janë shqiptarët në Mal të Zi ndërmjet shumëçkaje, por nga të gjitha anët të harruar dhe të përbuzur", është shprehur ai.

Autori i filmit dokumentar, mr. Haxhi Shabani, ka thënë se punimi i këtij filmi ka qenë një sprovë edhe për të.

Ai ka treguar se filmi është punuar me një numër të vogël bashkëpunëtorësh, të gjithë shqiptarë, sepse ka "dashur që filmi të jetë shqiptar".

Duke folur mbi vështirësitë në realizimin e filmit, Shabani ka thënë se përpos skenaristit i është dashur të luaj edhe rolin e regjisorit, për ç'gjë sipas tij, i ka ndihmuar shumë bashkëpunimi që ka pasur më herët me regjisorin e ndjerë Hysejn Bato Dukaj.

Ndërkaq, për problemin e shpërnguljes së shqiptarëve, që është në fokus të këtij filmi, Shabani ka thënë se ky "është një obsesion që po zgjat aq shumë", gjë që më së miri e pasqyrojnë imazhet në film.

Sipas tij, **mesazhi i këtij filmi dokumentar është se "shqiptarët në Malin e Zi janë aq pak saqë në qoftë se ndahen, atëherë sigurisht që krijohen probleme që pikërisht ndikojnë në humbjen e identitetit tonë".**

Pjesë e ekipit të filmit dokumentarit ka qenë edhe Samir Ismaili, i cili e ka realizuar kamerën dhe montazhin.

Në fjalën e tij, ai ka treguar për vështirësitë që kanë hasur, por edhe për momentet e bukura gjatë realizimit të filmit.

Ismaili ka bërë thirrje që projekte të këtilla të përkrahen edhe më tepër, "qoftë nga Komuna, diaspora apo edhe individë që kanë mundësi të kontribuojnë në këso lloj projektesh".

Mr. Haxhi Shabani ka realizuar deri më tani katër portrete dokumentare për Redaksinë Shqipe të Televizonit të Malit të Zi, si: për përkthyesin e "Biblës" në gjuhën shqipe, dom Simon Filipajn, veprimtarin humanitar dhe atdhetar, profesor Bajram Rexhën, dijetarin prof. dr. Ruzhdi Ushakun si dhe Shoqatën e Artistëve dhe Intelektualëve "Art Club".

Ai është autor i tri përmbledhjeve me poezi, një libri shkencor dhe një libri publicistik.

Realizimi i filmit dokumentar "Ndërmjet" është mbështetur financiarisht nga Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave.



NJË VEPËR E RËNDËSISHE E STPÇEVIQIT

Shkruan **prof. Dr Jahja Drançolli**, Fakulteti Filozofik, Prishtinë

Akademik Aleksandar Stipçeviq ka lindur në Arbresh të Zarës (1930). Vdiq në moshën 85-vjeçare në Zagreb. Studiuesit



Libri u përurua në Institutin Albanologjik, Prishtinë, më 8.04.2016. Folën prof. dr Zymer Ujkan Neziri, don Gabriel Grabanica, prof. dr Simë Gjon Dobreci dhe disa nga publiku. Me këtë rast u propozua – na shqiptarët ta nderojmë Stipçeviqin më të paktën me përmendore në Prishtinë, Tiranë dhe Ulqin.

dhe bashkëvendësit e tij që ia kanë njohur veprën e kanë konsideruar atë për njërin ndër shkencëtarët më të njohur shqiptar të shek. XX dhe fillimeve të shek. XXI. Karrierën e tij shkencore e kishte nisur si arkeolog në Muzeun e Zarës (1954), për të kaluar më pastaj në Institutin e Historisë, dega e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kroacisë në Zarë. Më 1957 ka kaluar për të udhëhequr sektorin e librit të shtypur në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare në Zagreb. Nga kjo pozitë është avancuar në pozitën e drejtorit të Bibliotekës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve në Zagreb (1977). Me fjalë të tjera bëhet fjalë për njërin ndër arbëreshët më të shquar të Zarës, i cili me të arriturat e tij shkencore në ilirologji, albanologji, histori, arkeologji, etnologji, bibliografi me bibliologji dhe sociologji të librit, zuri vend të merituar në "Bibliotekën" e dijetarëve më të shquar të botës sa u përket këtyre fushave shkencore.

E gjithë veprimtaria e tij deri në atë kohë ishte ngushtësisht e lidhur me librin dhe me mundësitë e mëdha për të botuar libra dhe për t'u avancuar në shumë fusha të shkencave humane dhe sociale. Emri i Stpçeviqit u bë i njohur si ilirolog në Itali dhe ish-Jugosllavi, që në vitin 1963, me botimin "Arte degli Illiri" në Milano, për të vazhduar po me aq sukses me botimin e "Gli Iliri" prapë në Milano, tre vjet më vonë. Për t'i finalizuar të arriturat e tij në fushën e ilirologjisë publikoi: "Iliri: povijest, život, kultura" (Ilirët - historia, kultura, jeta), Zagreb, 1974 dhe "Kultni simboli kod ilira" (Simbolet e kultit te ilirët), Zagreb, 1981. Kjo e fundit ishte edhe teza e doktoratës së tij. Akademia e Bosnjë-Hercegovinës ia kishte botuar dy vëllime monumentale studiuesit Stipçeviq: "Bibliographia Illyrica" dhe "Bibliographia Illyrica, Suplementum".

Pas botimit dhe ribotimit të vëllimeve në fjalë nga lëmi i ilirologjisë, studiuesi ynë me nam botërore ka arritur në një konstatim të pakontestueshëm dhe gjithandej të pranueshëm se "çdo tregim për Ballkanin fillon me ilirët". Stipçeviqi studimet i ka thelluar edhe në çështjen e etnogjenezës së shqiptarëve, pastaj atë të vazhdimësisë iliro-arbërore, e deri tek kultura tradicionale e arbëreshëve të Zarës, e monumenteve kulturo-historike në rrethin e tij.

Duke qenë student i Zarës kam pasur mundësinë që Akademikun e mirënjohur ta njoh për së afërmi edhe si studiues kulmor, siç e quanin bashkëvendësit e tij, më i mençuri nga arbëreshët e Zarës, por edhe si koleg në botime të përbashkëta të ish-Jugosllavisë, si dhe të Kroacisë së sotme.

Vdekjen e ilirologut më të madh ndër ne është një humbje të pakompensueshme për shkencën shqiptare, kroate, si dhe përgjithësisht të asaj botërore. Prej vitit 1983, Stipçeviq ishte anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Të gjitha këto angazhime të tija më tepër të natyrës shkencore – bashkëvepruese kanë bërë që studiuesit Stipçeviq t'i mbesin në dorë të pabotuara shumë materiale për shpërnguljen e abreshëve në Zarë, historinë e tyre në trevën e sotme të Komunës së Ulqinit dhe asaj të Tivarit gjatë mesjetës dhe periudhës së hershme osmane. Nga ky varg i veprave të pabotuara të A. Stipçeviqit, këto ditë pau dritën vepra me titull: "Albanci o Zadarskim Arbanasima- Shqiptarët për Arbëneshët e Zarës". Vepra në fjalë është botuar në sajë të përkujdesjes së Famullisë së Braticës së Ulqinit (Mali Zi), dhe të famullitarit Dom Gabriel Grabanica. Veprën që e kemi në dorë dhe jemi duke e shfletuar është botuar krahas në dy gjuhë, kroatisht dhe shqip (shqipërimin e ka bërë intelektuali dhe humanisti i shquar Prof. Dr. Simë Dobreci, me origjinë nga Bratica e Ulqinit. Edhe pse vepra është për nga madhësia vëllimore e shkurtër, ajo ofron një tabllo të tërësishme për shkrimet e shqiptarëve kushtuar Arbëneshit dhe arbëneshve të Zarës në aspektin historik, gjuhësor dhe letrar. Me fjalë të tjera përveç hyrjes ku bëhet fjalë për biografinë e shkurtër të autorit Stipçeviq (një pjesë e të cilës e paraqitëm më lartë), si dhe historinë e Arbëneshve të Zarës, libri është konceptuar në 3 kapituj të shoqëruara edhe me shënime dhe ilustrime interesante që i referohen çështjes në shqyrtim.

Kjo vepër sintetike e A. Stpçeviq synon të paraqesë evolucionin dhe kontinuitetin e veprave, studimeve dhe artikujve nga fushat historike, gjuhësore dhe letrare. Për gjerësinë e temës, kuptohet se lënda më relevante janë vetë botimet relevante të shkruara kryesisht në gjuhë shqipe. Autori, duke qenë konsekuent në idenë e një studimi të gjerë bibliografik dhe me një shtrirje kronologjike, vetiu na paraqet një studim të shtrirë në gjerësi, duke u përpjekur për të ndërthurur faktorët historikë, gjuhësor dhe letrarë, siç e kërkon një studim sintezë.

Tërheqë vëmendjen edhe në këtë rast për të përkujtuar se, për gjithë atë çka ka bërë Stipçeviqi për shkencën dhe kulturën shqiptare, ne i kemi mbetur shumë borxh jo vetëm atij por edhe arbëneshve të Zarës. Ju kanë mbetur borxh institucionet relevante shtetërore të Kosovës dhe të Shqipërisë, si dhe shqiptarët përgjithësisht, që mos ta humbin shansin për tu marrë me studime më të thelluara kushtuar arbëneshve të Zarës, si dhe për t'ia botuar të gjitha dorëshkrimet e pabotuara, si dhe të gjitha ato të botuara për t'i botuar sërish në komplet si do t'i përshtatet një niveli të studiuesit sikurse ishte Akademik Aleksandër Stipçeviq. Ndërsa, Famullia e Braticës, më ne krye me famullitarin Dom Gabriel Grabanicën, si dhe prof. dr. Simë Dobreci, të merrën si një model si nuk duhet harruar *Vires Illustris* (Burrat e Shquara) të Kombit.



Pod of Ljare – Arbanas of Zadar*

Written by **Besnik Simë Dobreci**

In July of 2004, I came across a web page prepared by Tom Smira Peroviq from Arbanas of Zadar, Croatia, now in Brisbane, Australia. On the web page, I learned about the mass migration of Shestani Albanians to Arbanas approximately 270 years ago. I was truly impressed by Tom's respect for his ancestors. My father always said, *"respect yourself by respecting your ancestors; respect your ancestors if you want others to respect you"*.

Tom's webpage contained two flags, Croatian and Albanian, a sign of respect for his birthplace, Croatia, and his heritage, Albanian. As Tom says, *"let us proudly remember we are Albanian, descendants of the great Illyrians"*. We began writing to each other about our common ancestry. Tom told me his family roots were in Pod, a village near Ljare. His ancestor, Boso Niko SMIRA, migrated to Arbanas, Croatia, in 1726. He wanted to know more about Pod and Shestan, and I was very curious about Arbanas. I told Tom I would be visiting my family in Bratica (Ulqin) in September of 2004 and would attempt to find out more about Pod.



Steps leading to Pod

On September 3, 2004, I arrived in Bratica. My father believed that Pod was located northeast of Ljare. On October 8, 2004, my brother, Leka, my wife, Yvonne, and my father left for Ljare. The breathtaking view of the Scutari Lake and neighboring villages forced us to stop at *Tarabosh*. As it has become customary in our family, we also visited our ancestor's old house, *"House of Gjonaj"*, located in the village of Dobrec. While in Dobrec, we also visited the house of Luka of Zef Luka Gjon Junku. My father's maternal grandmother was from this family. Luka's wife, Angja, invited us in and served us with honey, cheese and moonshine. Hanging on the wall, I noticed an old photograph of Angja in company of my mother, both wearing Shestanian traditional costumes.

Angja told us that ever since Pod was abandoned by its people, each year a church mass was held to bless the souls of Pod people wherever fate took them. The mass was held annually until the end of Second World War when the communists came into power.

While in Ljare, we visited 84-year-old, Gjon Kol Nilaj, who told us that Pod people were the first ones who migrated to Zadar. He also told us that Pod still contained ruins of an old church and cemetery.

Three days later, we returned to Ljare. As we had never visited Pod before, my father arranged for a guide. He contacted Luka of Gjergji Luka Kola TAGAJ *(Luka i Gjergjit Luk's Kol's TAGAJ)* currently living in Ljare with his wife, son and grandchildren. Luka sent his 16 year old grandson, Dragan of Gjergji Luka Gjergji Luka Kola TAGAJ *(Dragani i Gjergjit Luk's Gjergjit Luk's Kol's TAGAJ)*. Dragan told us that the only way down was through steps built of hand-carved stones. While walking down the hundreds


Church or house


Church & Cemetery

of these steps, we were in awe with the hard labour and great mastery needed to build these steps.
Half-way down the mountain, we stopped by *"Ubla e Nushkut* – Nushku's Well". We drank some water and continued our trek.
Pod appeared to have been a small village, made up of between fifteen to twenty houses. It is bounded by Ljare to the southwest, Mardhaj to the southeast, Besi to the northwest, and Maçiluka and Scutari Lake to the northeast. The village was surrounded by a stone wall. The wall was approximately meter and a half high and half meter wide. We were all surprised by this wall, as a wall surrounding an entire village did not exist anywhere else in Shestan. My father suggested that the wall may have been built to keep domestic animals from entering the village thus destroying the crop.
A pavement built of hand-crafted stones was immediately outside the village walls. The pavement was approximately two meters wide and extended all around the village. While walking on the pavement towards the church of Pod, we noticed ruins of, what appeared to be, an old building. We could not say for certain whether the building was a church or a house. This building was situated on a hill, approximately thirty meters west of the village walls. It was, and still is, common in Albanian regions for catholic churches to be built on a hill looking upon the village. The building had two entrances, one to the east and one to the south. The east entrance led to the lower level, whereas the south entrance led to the upper level. The west wall of the lower level was semi-circular. The south wall of the lower level had two small window-size alcoves, possibly used to place lit candles. The walls were made of large stones, some of them approximately one square meter. The walls were approximately meter and a half thick. The whole building was approximately twelve meters by ten meters. The lower level was larger than the upper level. Besides the church of Pod, we could not find any other similar buildings inside or outside village walls. Although it appeared more like a church than a house, only archeologists will be able to ascertain. We left the building wondering how the people of Pod could build such a structure.
A few minutes later, we arrived at the church of Pod. The church was quite small; approximately 9 meters by 7 meters. The walls were dry (i.e., no building compound) and approximately one meter thick. We saw, what we thought, were tombstones outside the church. However, as most of these tombstones were left at the mercy of time and were covered with grass and dirt, we could not find any writings on them.
Around the village, we found ruins of old houses. Olive trees inside the village were old and plentiful. Even following migration of the Pod people to Arbanas, as Kruno Krstic in "*Rječnik govora Zadarskih Arbanasa"* writes, they continued being involved in the olive business. These olive trees now belong to the residents of Ljare. How this change of ownership occurred remains unknown. After spending some time in Pod, we began walking back to the "Saddleback of Cervica". As the weather had turned extremely hot, it took us over an hour to make it back to our starting point.
My visit to Pod was amazing, yet disheartening. I was amazed by the great mastery of the Pod people, but was disheartened because this wonderful place is completely abandoned. Nevertheless, I am encouraged by the likes of Tom of Jaku Josip Joko Mitri Dujo Mate Sima Stjepa Nikolla Boso Nika Smira-Peroviq who are proud of their Albanian roots. As he says, *we will always be Albanian, until our last drop of blood. Pod will never die or forgotten.*

*In Albanian language printed in BUZUKU 17, 2005:10.


Leka, Besnik's brother

Katedralja e Shnjonit në Shas

Shkruan **msc Anton Lulgjuraj**





Rrasa në mur të Katredales Shnjonit (mbi tokë cca 1 m, djathtas prej derës cca 50 cm) e prishur; vihen re shkronjat latine, ku do të ketë qenë data e ndërtimit. Djathtas mbështetë rrasës është i gdhendur kelku (kupa), me të cilën gjatë meshës prifti pi venën (simbol i gjakut të Krishtit).

Në fund të vitit 2015 dhe në fillimin e vitit 2016 në pjesën e sipërme të qytetit të lashtë të Shasit janë zhvilluar gërmime arkeologjike të udhëhequr nga Muzeu Nacional i Cetinës në





kuadër të projektit "rrugët e vazhdimësisë". Në këtë lokalitet janë ndërmarrë edhe ekspedita tjera në vitin 1985 nga Universiteti i Beogradit dhe në vitin 2012 nga Muzeu Nacional i Cetinës. Në ekspeditën e fundit qëllimi kryesor ishte gërmimi arkeologjik i katedrales së Shnjonit (Shën Gjon Pagzuesit) që ndodhët pranë hyrjes në qytetin e sipërm.

Katedralja e Shën Gjon Pagëzuesit është e njohur prej udhëpërshkruesit arqipeshkvit të Tivarit, Marin Bici, në udhëtimin e tij në arqipeshkvinë e Tivarit në vitin 1610, atëherë kur ishte nën pushtimin Turk. Ai e përshkruan gjendjen e mjerueshme të kishës, e cila në atë kohë ishte e varfër. Marin Bici tregon se në Shas gjithë popullsia ishte katolike shqiptare. Ai, në ditën e vizitës se vet, bën krezmimin e 53 fëmijëve në kishën e Shën Gjonit. Ipeshkvia e Shasit përmendet edhe më herët. Më 1166, Pjetri, ipeshkvi i Shasit (Suacinense), mori pjesë në shenjtërimin e katedrales katolike të Kotorrit*. Këto për një arkeolog apo historian janë fakte të rëndësishme, mbasi hedhin dritë për të kaluarën e këtij vendi; ky ende është i gjallë si vendbanim edhe pse i varfër dhe i mjerueshëm.

Kisha ka dimensione te mëdha dhe në pjesën e absidës ka një kalim ku lidhet me kullën e kambanores. Kisha në mes ndahet në dy pjesë me një mur, në pjesën e lterit dhe në pjesën e popullit. Gërmimet në vitin 1985 kanë dhënë pak informacion për kishën në fjalë. Më tepër ato kanë qenë të tipit arkitektonik. Ata kanë vërejtur se kisha kishte një dysheme e cila për shkak te terrenit jo të rrafshet, ajo ishte e shkallëzuar. Gjatë gërmimeve është hasur në pjesë të kishës më të vjetër, mbi të cilën është ndërtuar kisha, të cilën e shohim neve sot. Supozojmë së kjo kishë është ndërtua mbas shkatërrimit prej Mongolve.

Nga gërmimet e këtij vitit janë gjetur muri i kishës dhe pjesë te dyshemesë së vjetër. Po ashtu janë gjetur mbi 30 varre brenda hapësirës së kishës. Pjesa më e madhe e këtyre varreve janë të 3 shekujve të fundit. Pra nga Marin Bici kemi informacionin e saktë se kjo kishë ishte në funksion në vitin 1610. Pra varrosja masive duhet të ketë ndodhur pas kësaj datë, në momentin kur kisha shkatërrohet dhe në të besimtaret katolik kryejnë varrosjen e familjareve të vet. Inventari i këtyre varreve është shumë i pasur me stoli. Kryesisht janë kryqe dhe medaljone me tematikë religjioze të konfesionit katolik. Në shumë prej tyre janë të paraqitura Jezusi, Shën Mrija, Shën Antoni, Shën Nikolla etj. Interesant është shumë vorri i gjetur në pjesën e absidës. Ai u gjet i plaçkitur nga kërkuesit e më të hershem, por prapë patëm fatin të gjejmë disa monedha venedikase të shek. XIII. Po ashtu janë gjetur një numër i konsiderueshëm i monedhave osmane, të cilat dëshmojnë kohen e braktisjes të kësaj kishë si objekt në funksionim.

Shpresoj se këto gërmime të japin rezultate të mira për shkencën. Po ashtu pres që konservimi i kishës të shkoj në atë mënyrë, ku mundet të tregohet sa më tepër në origjinalitet, ashtu si dhe është e njohur në të kaluar: Katedrale Katolike e stilit Romanik.

*Buzuku 35, 2011:3.



Xhamia e Meterizit* (sot kisha ortodokse)

Shkruan ***Prim.Dr.Gani Karamanaga***

Menjëherë në hyrje të Kalasë së Ulqinit bie në sy kisha ortodokse. Ajo është ndërtuar në fillim të shekullit XX në vendin ku deri atëherë ka qenë Xhamia e Meterizit. Është e vërtetë se kjo kishë



është ndërtuar me gurët të cilët i kanë marrë prej bedenit të Kalasë. Gjithashtu me këto gurë është ndërtuar edhe shtëpia e Simo Popoviqit në Ranë. Pas rrënimit të xhamisë dhe ndërtimit të kishës malaziasit mbollën ullinj të cilët ende sot janë aty.

Shoku im Ramazan Uruçi, më tha se edhe të parët e Uruçëve janë të varrosur në oborrin e kishës së sotme.

Premtimi i sundimtarit Nikolla Petroviq për rindërtimin e xhamisë së rrënuar në lagjen Meteriz

Dokumenti i 19 shtatorit të vitit 1891;

"Odobrenje ulcinjskim muslimanima da sagrade novu džamiju;

Mojim vjernim podanicima varoši Ulcinja, imenom muhamedancima mahale Meteriz na mjesto stare, sklone padu sklonjene džamije u istoj mahali. U znak moje vazdanje ljubavi prema Vama, mojim vjernim podanicima i stalne želje da ste u vašoj vjeri slobodni i napredni naredio sam da primite 3.000 groša kao pomoć gradnje gore pomenute džamije; Nikola".

Në vitin 1991 knjaz Nikolla i Malit të Zi i shkruan qytetarëve të Ulqinit ku i premton ndërtimin e një xhamie të re në lagjen Meterizi, në vend të asaj e cila ka qenë e vjetër dhe të cilën e kanë rrënue dhe zhdukur prej ati vendi. "*Si shenjë i vullnetit tim të mirë, Juve qytetarëve të mi… merrni 3.000 grosha për ndërtimin e xhamisë të përmendur*"…Por ,xhamia nuk u ndërtuar asnjëherë më. Në vend të xhamisë u ndërtua Kisha e Shën Nikollës me gurë t'marrë nga bedeni i Kalasë së lasht të Ulqinit.

Në të dhënat biografike për vojvodë *Mark Milanin* është shënuar edhe kjo, që në vitin 1897, ai ka qenë në Ulqin dhe me interesim të veçantë dy herë ka qenë në Kala. E ka dalluar se gurë nga bedeni ishin hequr, andaj pyeti: *"Kush në mënyrë katile shkul gurët e murëve ?...Dikush do ta akuzojë atë edhe juve, e po shoh se nuk jeni të varfër me gurë:"*

Tre raste lidhur me Xhaminë e Meterizit

Rasti 1. Para 15 vitesh ishim duke u kthyer prej një rasti vdekjeje në afërsi të kishës ortodokse nën Kala. Në oborrin e kishës ishte popi *Radojica Bozhoviq. Shyqyri Kahari* iu afrua edhe e pyeti: "*Mirëdita zotëri, sa është e vjetër kjo ullishte në oborrin e kishës?"*. Popi pa menduar aspak, iu përgjigj: *"Kjo është ullishte relativisht e re, rreth njëqind vjetësh.."*(kjo kohë përputhet me kohën e rrënimit të xhamisë dhe ndërtimit e kishës).

Rasti 2. Para 10 vitesh më ftoi një mik nga Mali i Brisë në festën familjare të shtëpisë së tij. Kur u kthyem me mua në veturë ishte edhe një komshi imi malazias. Duke kaluar pranë kishës komshia më tha*: "Kjo shtëpia e re përdhese, afër kishës, shitet. Edhe çmimi nuk është aqë i lartë"*. Unë e pyeta pse nuk e blen ai që e ka mundësinë. Ai menjëherë u përgjigj: "Zoti na ruajt, kurrë nuk do të blejë në këtë vend". Shpjegim:në afërsi ka qenë xhamia,12 në anën veriore kanë qenë tri tyrbe.

Rasti 3. Më 27 korrik 2015 pati prishje në kabelin nëntokësor të rrymës elektrike, në rrugën veriore afër kishës ortodokse në Meteriz. Punëtorët duke punuar gjetën disa eshtra dhe një gur varri i fesë Islame Për këtë gjë u njiohtua bashkësia Islame e Ulqinit.

Konflikti me popin ortodoks

Ndodhi para Luftës së Dytë Botërore. Ne kemi pasur ullishtë në dy vende, në Lima dhe në Mal të Bardhë. Një ditë babai, *Hasan Cano Karamanaga* ishte duke u kthyer prej ullishtes, Gomari i ikën dhe hyn brenda në oborrin e kishës. Aty ndodhi popi i cili filloi të flasë me ton të lartë, duke thënë se gomari ka hyrë në kishë, në vend të shenjtë…Babai e dëgjoi dhe pas një kohe i përgjigjet: "*Më së pari, më vjen shumë keq që gomari më ka ikur…por,edhe një gjë tjetër, gomari është duke ecur edhe sipër varrezave të të parëve të mi…Babai im mulla Ismail eff.Kahramanaga ka qenë imam në këtë vend kur ka qenë Xhamia e Meterizit"*

Erdhi lufta, u ndërruan okupatorët. Pas vitit 1945 komanda e partizanëve ka qenë në ish hotelin "Jadran". Popi ortodoks e lajmëron babain lidhur me konfliktin që kanë pasur para disa vitesh. Filluan pyetjet. Ishte prezent edhe popi. Babai në mënyrë qetësuese i përsëriti fjalët e sipërme.

*Sipas kronistit Anonim nga Venediku në vitin 1521, vendi ku ndodhet kisha e sotme ortodokse quhej Shën Domeniku (loco San Domenico), pra, aty do të ketë qenë kishë katolike shqiptare, më vonë e ndryshuar në xhami, mendon Msc Anton Lulgjuraj.

Kisha ortodokse e ndërtuar pas rrënimit të xhamisë (viti 1890).Këtu ka qenë imam edhe Smail eff. Karamanaga



Revistë e hapur për të gjithë krijuesit

Shkruan **Ismet Kallaba**

Ulqin – Në prani të një numri të vogël të publikut, në Bibliotekën e Ulqinit më 9.10.2015 u përuruan numrat 13 dhe 14 të revistës për shkencë, kulturë, art "Dija", e cila botohet nga Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi.



Në fjalën përshëndetëse në emër të organizatorit, Dr. Nail Draga, drejtor i Qendrës Kulturore, ka thënë se për nga numri i revistave shkencore, shqiptarët në Mal të Zi ndonëse nuk janë popullatë numerikisht e lartë, mund të krahasohen me mjedise me popullsi shumë më të madhe, duke përkujtuar se përpos revistës "Dija", këtu dalin edhe revistat "Lemba" dhe "Malësia".

Ndërkaq, duke folur për revistën "Dija", ai ka thënë se deri më tash ajo e ka arsyetuar daljen e saj, "por çështja është se di do të vazhdojë më tutje 'Dija' duke marrë parasysh se mungesa e mjeteve financiare kushtëzon botimin e kësaj reviste dhe revistave të tjera".

Kryetari i BKSHMZ-së, prim. Dr. Gani Karamanaga, ka theksuar se këtë vit kanë dalë dy numra të revistës "Dija" e cila, sipas tij, është bërë e njohur në rajon dhe diasporë.

"Kjo revistë ka qenë dhe është e hapur për të gjithë krijuesit shqiptarë, por edhe ata malazias, për arsye se disa tekste i kemi përkthyer në gjuhën shqipe", ka thënë Karamanaga.

Redaktori teknik i revistës "Dija", Gazmend Çitaku, bëri një prezantim të shkurtër të numrit 13 të saj, duke thënë ashtu si dhe në numrat e mëparshëm, edhe në këtë numër ka tema të mira dhe aktuale.

"'Dija' numër 13 është shumë e pasur, jo vetëm me autorë nga Ulqini, por me autorë nga të gjitha trevat shqiptare, si dhe me autorë shqiptarë që jetojnë jashtë", nënvizoi ai.

Ndërkaq për numrin 14 të revistës "Dija" foli publicisti Mustafë Canka.

Ai tha se kjo revistë është bërë enciklopedi e llojit të vet te shqiptarët në Mal të Zi.

"**Duke pasur parasysh strukturën, llojin dhe mënyrën e teksteve, si dhe autorët që janë të përfaqësuar aty, është lehtë të konkludohet që revista mbetet serioze, gjithëpërfshirëse dhe kombëtare**", vlerësoi ai, duke shtuar se botimi i çdo numri të revistës "Dija" është ngjarje kulturore dhe arritje e vërtetë për komunitetin tonë.

Në emër të Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, i cili e ka mbështetur botimin e numrit 14 të revistës "Dija", përshëndeti drejtori Safet Kurtagiq, i cili tha se është i kënaqur që ky institucion ka mbështetur deri tani botimin e tre numrave të kësaj reviste, duke uruar që ajo të përjetojë në të ardhmen ditë më të mira.

Me këtë rast, Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi ndau Mirënjohje për disa bashkëpunëtorë të revistës "Dija" dhe persona që kanë ndihmuar në mënyrë financiare daljen e saj. Kështu Mirënjohje iu ndanë dr. Maksut Haxhibrahimit, piktorit Rudi Goga, redaktorit teknik të revistës "Dija" Gazmend Çitaku, drejtorit të Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, Safet Kurtagiq, kryetarit të Komunës së Ulqinit, Fatmir Gjeka, dhe kryetarit të BKSHMZ-së, prim. Dr. Gani Karamanaga.

Përurimi u organizua nga BKSHMZ në bashkëpunim me Bibliotekën e Ulqinit – Qendra e Kulturës Ulqin.

Botimin e numrit 13 të revistës "Dija" e ka mbështetur Komuna e Ulqinit, kurse botimin e numrit 14 Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave.

Numri i parë i revistës "Dija" ka dalë në vitin 2003.



Fadil Kroma na dha librin SHËNIMET E BIBLIOTEKISTIT –
130 vjetori i sallës së leximit të Bibliotekës Popullore “Mirko Srzentiq” 1884-2014, Ulqin, 2015

Një libër për Bibliotekën e Ulqinit

Përgatiti **Ismet Kallaba**

Ditë më parë doli nga shtypi libri i parë i Fadil Kromës ”Shënimet e bibliotekistit”. Ky libër pasqyron 130 vjetorin e sallës së leximit pranë Bibliotekës së Ulqinit, i cili aty edhe u promovua më 23.12.2015. Hapja e Bibliotekës para 130 viteve, hapat e parë në furnizimin me libra,



pasurimi i fondit me botime në gjuhën shqipe dhe sfida me pushtetin e atëhershëm që, edhe kur nuk kishte asgjë mundohej t'i mveshte epitete të ndryshme.
Libri ”Shënimet e bibliotekistit” përveçse është një biografi e bibliotekës, pasqyron edhe aktivitetet ndër kohë të udhëheqësit


Foto më 1910, në Ulqin; Mësuesi Mitar Iveliq me 44 nxënës (meshkuj e femra), ndër këta 2 harapë (zezakë, çka e vërteton që fotografia u bë në Ulqin); 7 nxënës meshkuj kanë qeleshe në krye, çka dëshmon që edhe ulqinakët e kishin traditë të mbulonin kryet me qeleshe (plis).

të këtij institucioni, i cili me një precizitet kirurgjikal shpalos të gjitha ngjarjet kryesore lidhur me bibliotekën, që nga pasurimi i saj me libra të dhuruara nga qytetarë të ndryshëm, pastaj solidariteti në vepër i bibliotekave dhe i institucioneve të ndryshme në ish-Jugosllavi dhënë ndërtimit dhe pasurimit të Bibliotekës së Ulqinit, organizimi i aktiviteteve kulturore në të dy gjuhët, ku të pranishëm ishin emrat më të mëdhenj të kohës nga fusha e kulturës dhe e letërsisë, si asaj shqiptare ashtu edhe malazeze.
Vëmendje të veçantë paraqet themelimi i Fondit të vendlindjes, që ka për qëllim t'i mbledhë të gjitha botimet e autorëve që kanë lidhje me Ulqinin, fond i cili kohë pas kohe u pasurua mjaft dhe paraqet një sektor të çmueshëm në këtë bibliotekë.
Pa dyshim, ky libër paraqet një doracak të vlefshëm në këtë fushë dhe një burim të madh informacionesh për bibliotekën që nga themelimi e deri në ditët e sotme, ilustruar me fotografi, faksimile dhe tabela të ndryshme me të dhëna statistikore dhe arkivore.
Libri “Shënimet e bibliotekistit” u botua si projekt vetanak i autorit, me mbështetjen e Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave të Malit të Zi.



Po vjen një poet

Shkruan **Ismet Kallaba**



Ulqin – Në sallën e mbushur plot të Bibliotekës së Qytetit në Ulqin, më 14.10.2015 u bë përurimi i përmbledhjes me poezi "Heshtja që vërret" e autorit Argëzon Sulejmani.

Edhe pse ky është libri i parë i këtij autori, poezitë e tij janë vlerësuar lart nga të gjithë folësit.

Studiuesi i letërsisë, Mr. Haxhi Shabani, ka thënë se duke marrë në shqyrtim librin me poezi të autorit Argëzon Sulejmani, përfundimi i parë pasi që e ka lexuar e rilexuar atë është se në skenën letrare po vjen një poet i cili plotëson disa kritere bazë të poezisë.

"Në pjesën më të mirë të poezive të tij, ai ka stil, di të përdorë gjuhën, të krijojë leksikun poetik, të shfrytëzojë figurën, guxon të eksperimentojë. Noton brenda metodave të ndryshme letrare. Ka këndshikimin e tij të gjërave, dukurive e proceseve. Artikulon shprehjen vetjake të ndjenjave. Kaq është e mjaftueshme të ketë një libër poetik, i quajtur 'Heshtja që vërret', i cili ndonëse është i pari, i kalon caqet e të qenit i parë", ka thënë ai.

Duke iu referuar titullit të librit, Shabani ka theksuar se "heshtja e këtij poeti flet, bërtet, vërret, pisket, sokëllin, dhe më në fund, mbyt dhe vret, sigurisht për ata që kanë veshë të dëgjojnë dhe sy të shikojnë".

Moderatorja Ardita Rama, udhëheqëse e Bibliotekës së Ulqinit, është shprehur se poezitë e Sulejmanit "tregojnë një pjekuri poetike të rrallë dhe të befasojnë me fuqinë e fjalës që pak poetë e posedojnë".

"Me një stil të veçantë shpalos mendimet e emocionet që, dasht e padasht, të prekin në shpirt. Të gjitha poezitë përmbajnë në vete një histori, që me ato pak vargje lexuesi i përjeton sikur të ishin tablo të gjalla që shpalosen para syve duke përjetuar fuqishëm çdo fjalë, pikë e presje", ka thënë ajo.

Botuesi Gazmend Çitaku ka thënë se qëkur ka lexuar poezitë e para të Sulejmanit, ka besuar tek ai.

"Sapo e pashë poezinë e tij të parë, mu para tre vjetësh kur e hapa për të parën herë konkursin e poezisë, njoha potencialin", ka theksuar ai, duke shtuar se "Heshtja që vërret" paraqet një përmbledhje shumë serioze dhe shumë të mirë.

Në fjalën e tij, autori Argëzon Sulejmani ka thënë se përmbledhja "Heshtja që vërret" vjen në një kohë idhnake, kohë të cilën studiuesit dhe kritikët letrarë ashpër e kanë përqasur me koferin e Konicës, duke aluduar vetëm në një kofer veprash cilësore në mbarë krijimtarinë tonë kombëtare.

"Unë aspak nuk pretendoj të hyj as në koferin e Konicës e as të ngrihem në përmendore. Më mjafton të komunikoj e të kuptohem me të tjerë si unë. Të kuptohemi që vërritma nuk kupton medoemos çmendi, që heshtja nuk përbën medoemos miratim, që ombrellë e këtyre të dyjave është liria dhe që më të bukurat vjersha janë gjetur në shi", është shprehur ndër të tjera ai.

Në emër të Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, i cili ka ndihmuar botimin e librit, ka përshëndetur drejtori Safet Kurtagiq, si dhe janë lexuar vështrimi i redaktorit të librit, Jaho Kollari, dhe përshëndetja e Azem Deliut, shkrimtar i ri nga Skënderaj, mik dhe njohës i poezisë së Sulejmanit.

Poezi nga libri recituan aktori Shefqet Luca, moderatorja Ardita Rama, botuesi Gazmend Çitaku, si dhe nxënësit Behar Pali e Jetlira Hoxha.

Argëzon Sulejmani ka mbaruar Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe punon mjek. Vëllimi poetik "Heshtja që vërret", i cili përbëhet nga 137 poezi, është libri i tij i parë. Ai është botuar nga Shtëpia Botuese "Diti&Oli".

Përurimi është organizuar nga Qendra e Kulturës – Biblioteka e Qytetit – Ulqin dhe Libraria "Arti".



Fotografia si pasion

Shkruan **Gazmend Çitaku**



Pas një kohe të gjatë, më në fund jemi të pranishëm në një ekspozitë të fotografive. Edhe pse fotografia me kalimin e saj në digjitale ka pësuar një ekspansion të madh, për fat të keq këtu te ne ka mbetur në suaza të *selfive* të ndryshme, të cilat pa ndonjë kriter publikohen nëpër rrjetet sociale.

Kohë më parë isha i pranishëm në një ekspozitë të fotografive, të organizuar në Shkodër. Në të vërtetë, një kombinim i ekspozitës së fotografive dhe recitimit të poezive. Gërshetimi i këtyre dy arteve me ambientin bëri që askush mos të mbetet indiferent.

Sot jemi mbledhur te Jetlir Kovaçi, një djalë entuziast i cili pasionin e vet të fotografisë dëshiron ta ndajë me ne. Kohë më parë ai pati një ekspozitë personale në Qendrën Kuturore të Kosovës në Stamboll, kurse sot na prezantohet këtu në Ulqin me një pjesë të vogël nga opusi i tij fotografik.

Jetliri në fondin e vet ka fotografi të kategorive të ndryshme, duke filluar nga ato urbane, sociale, etnografike, arkitektonike dhe artistike. **Qëndrimi i tij në Stamboll, ku është duke studiuar, ka bërë që në mënyrë të pavetëdijshme, duke përdorur kombinimet e ngjyrave kuq e zi në fotografi, të shprehë mallin për vendlindje.**

Vetë profesioni i ardhshëm i Jetlirit, arkitektura, e bën atë që gjatë zgjedhjes së subjekteve apo pamjeve të jetë i vëmendshëm dhe kërkues. Perspektiva dhe thellësia e fokusit paraqiten në mënyrë korrekte me një ekspozicion të saktë dhe i mbështjellë me ngjyra të ngrohta.

Këto fotografi më të qëndrueshme i bën edhe mosndërhyja e tyre me programe të ndryshme kompjuterike, ku sot manipulimet janë bërë të përditshme dhe autenticitetin e fotografisë e humbasin dhe e zbehin.

Në fotografitë e Jetlirit më pëlqen përdorimi i ndriçimit sepse me anë të dritës ai ia arrin të theksojë hijet e subjektit, paraqiten ndjenjat intime në portretet e subjekteve sociale, si dhe objektet arkitektonike fitojnë grandiozitetin e vet. Këto fotografi janë të mrekullueshme dhe delikatesa e tyre qëndron në faktin se si Jetliri i qaset dhe si ai e trajton subjektin, se si syri i tij kap momentin.

Në momentin që Jetliri do të kërkojë diçka më shumë nga fotografia që krijon, atëherë ai duhet që të fillojë dhe të luaj me ekspozicionin, me kohën e futjes së dritës në fotografi. Atëherë atij do t'i hapen horizonte të reja të lojës dritë-hije dhe granulacionet që do t'i shfaqen në fotografi do t'i japin plotësisht domethënie të shumanshme fotografive të tij.

Unë, duke e njohur dhe duke besuar në potencialin e Jetlirit, shpresoj se me fondin e fotografive që ka, do të bëjmë një ekspozitë tematike më të fuqishme sesa kjo që jemi sonte të pranishëm dhe se emocioni që do të shfaqet do të jetë më i fuqishëm.

(Fjala me rastin e hapjes së ekspozitës fotografike të Jetlir Kovaçit në Galerinë e Arteve të Qendrës së Kulturës – Ulqin, më 30 janar 2016)




Rrugëtimit të mërgimtarëve tonë në Amerikë

Shkruan **don Gabriel Grabanica**

Nga data 15 Dhjetor 2015 e deri më 10 Janar 2016, pata fatin që te qëndroj në diasporën më të fuqishme shqiptare. Vizituem komunitetet katolike në New York, Chicago, Michigan, si dhe shumë institucione, shoqata dhe organizata shqiptare. Mbas kthimit në vendin tim mora t'i thuri në tekst disa fjali falënderimi për këta bij e bija të këtyre trojeve shqiptare që kanë emigruar me dhjetëra dekada më parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; malli i tyre për vendin e lindjes nuk shuhet kurrë.

Pata rastin drejtpërdrejt të jem në shumë festime të Krishtlindjes dhe Vitit te Ri. I jam mirënjohës Kishës Katolike Shqiptarë në New York, në krye më famullitarin Don Pjetër Popaj, për pritjen, si dhe për veprimtarinë e sajë fetare, kulturore, kombëtare. Po ashtu i falënderoj për ndihmë të madhe që pareshtur e jep për Kishat e trojeve tona, si dhe për çdo lloj ndihmë që e japin njerëzit vullnetmirë.



Don Gabriel Grabanica me fëmijët e mërgimtarëve në Nju-Jork, Amerikë.

Isha shumë i nderuar që në manifestimet e festave të Krishtlindjes të jem mysafir nderi në shumë mbrëmje dhe festa të organizuara. Nder to do të veçoja në festën e familjes Mark Gjonaj, të organizuar nga zoti i kësaj familje, ky njëkohësisht kryetar i Bronxit, ku pata nderin t'i përshëndes mysafirët e pranishëm dhe ta bekoj darken e asaj nate. Në festën e vullnetarëve të Kishës Zoja e Shkodrës, më shumë nderim, shumë bashkatdhetarë na uruan mirëseardhjen në komunitetin katolik.

Po ashtu një emocion i veçantë ishte edhe pritja e Vitit te Ri në mesin e Fondacionit Don Simon Filipaj më seli në New York. Fondacioni i kishte bashkuar djemtë e vajzat, vëllezërit e motrat, familjar dhe miq më të mirë të Komunitetit Shqiptar në New York. Ata që për 12 muaj ndihmojnë kategoritë më në nevojë në trevat e Ulqinit dhe më gjerë.

Nuk mundem mos të përmend diasporën në Chicago. Në organizimin e përvitshëm që bijtë e bijat Shestanas organizojnë festimin e Krishtlindjes. Pata rastin të jem atë natë edhe në mesin e shumë Shestanasve që me dekada jetojnë dhe veprojnë në Chicago dhe ata për në asnjë moment nuk e kanë harruar vendin e tyre, vendin e të parëve. Përshëndetja ime në atë festë ishte nxitje që te vazhdojnë këtë traditë për të mirën e dhjetëra fëmijëve që ishin atë natë aty. Pas bekimit që i bëra atë natë, gazmendi vazhdoi më këngë e valle nga këngëtari Lidon Gjelaj.

Surprizë e këtij rrugëtimi ishte edhe vizita e Komunitetit Shqiptar të mërgimtarëve tanë në Michigan. Vizitova dy Kishat shqiptare, ajo e Zojës së Shkodrës dhe Kisha e Shën Palit. Komunitet i gjallë, ishte i gatshëm të ndihmojë gjithmonë për çdo iniciativë. Kontributi i tyre është aq i madh, saqë mund të shkruhën me dhjetëra libra; do te shkruhen në të ardhmen për atë mori kontributesh që kjo Kishë e ky komunitet ka dhanë për të mirën e Kishës, kulturës dhe kombit shqiptar.



Don Gabriel Grabanica me shqiptarët shestanas mërgimtarë në Nju-Jork, Amerikë


Don Gabriel Grabanica me Mark Gjonaj, kryetar i Bronksit të Nju-Jorkut, Amerikë.

Kam shumë për të shkruar dhe për të thënë për një përvojë disa javore në mesin e vëllezërve dhe motrave tona në Shtetet e Bashkuara të Amerikës . Por po e përmbyll më një mendim tim.
Komuniteti Katolik në Amerikë, në këtë rast po e veçoj New Yorkun, është shembull i unitetit të besimtarëve të shumë krahinave shqiptare. Aty asnjëri nuk ndihej i huaj apo i përjashtuar. Të gjithë shqiptarët bashkë: Shestanas, Ulqinak, Malsor, Kosovë apo Shqiperi. Të gjithë ishin unik së bashku më famullitarin e tyre Don Pjetrin. Ishte një shembull i mirë për Kishat dhe famullitë tona në trojet tona. Nëse dëshirojmë bashkëpunim atëherë e kemi shembullin e Kishës në New York.
Komuniteti shqiptar në New York ishte shumë unik rreth të përzgjedhurit të tyre politik z. Mark Gjonaj, figure e shquar në fushën e biznesit, politikës, dhe shembull i mirë edhe shumë familjarë dhe karizmatik. Më shembullin e tij dhe punën e tij mburret çdo shqiptar në New York. Është shembull i mirë edhe për njerëzit tanë që merren më politikë në trojet tona. Do ishte një bekim i madh për ne që të kemi udhëheqës dhe përfaqësues të tillë.
Diaspora shqiptare është një shkollë edhe fetare edhe kombëtare edhe politike për ne. Shpresojmë që përveç të mirave ekonomike që i marrim nga ata, të kemi guxim të kërkojmë edhe ndihmë në udhëheqjen e mirë si në aspektin fetar ashtu edhe atë politik.


Don Gabrieli me kryesinë e Fondacionit Dom Simon Filipaj, Nju-Jork, Amerikë.

Rrok Gjonlleshaj - argjipeshkvi i ri në Tivar

Përgatiti **Don Gabriel Grabanica**

Më 5 prill 2016, Papa Françesku emëroi Don Rrok Gjonlleshaj, argjipeshkëv të Argjipeshkvisë së Tivarit – Mali i Zi, lajmëron gazeta zyrtare e Selisë së Shenjtë "L'Osservatore Romano". Është lajm i bukur për Kishën tonë në Kosovë që na gëzon të gjithëve. Don Rroku është prifti i dytë nga Kosova që zgjidhet në selinë e Argjipeshkvisë së Tivarit, pas Imzot Zef Gashit, tash në pension. Kisha Katolike e Kosovës i dëshiron hire dhe bekime në shërbimin e tij baritor në Kishën e Tivarit.
Don Rrok Gjonlleshaj, është meshtar i Administraturës Apostolike të Prizrenit (Ipeshkvia e Kosovës), i lindur më 10 shkurt 1961 në Velezhë, komuna Prizrenit, prej prindërve Mark dhe Pashke lind. Bisaku. Është pagëzuar në Famullinë e Shën Nikollit në Velezhë (Prizren). Shkollën Fillore e ka kryer në vendlindje, kurse Gjimnazin Klasik "Paulinum" në Suboticë (1976-1980).
Studimet filozofike dhe teologjike i ka kryer në Rijeka të Kroacisë



(1980-1987). Pas diplomimit në teologji, shugurohet meshtarë më 1 gusht 1987. Emërohet ndihmës famullitar në Zllakuqan në vitin 1987-1989.
Në shtator 1989 emërohet famullitar i Famullisë së Shën Jozefit në Stubëll, detyrë të cilën e kryen deri në gushtin e vitit 2007. Në Famullinë e Stubllës angazhohet në pastoralin e të rinjve, pastoralin e thirrjeve dhe punë të ndryshme në ristrukturimin e jetës në Famulli. Në bashkëpunim me Këshillin e Fshatit inicion Manifestimin kulturor "Takimet e Don Mikel Tarabuilluzit", të cilat do të marrin përmasa kombëtare.
Në shtator të viti 2007 emërohet famullitar i Bishtazhinit dhe aty shërben deri në dhjetor 2010, kur emërohet famullitarë i Prishtinës, detyrë që e kryen edhe sot.
Qysh meshtar i ri, do të bëhet anëtarë i Këshillit Presbiterial (1990 – 2016).
Don Rrok Gjonlleshaj ka kryer disa detyra në Ipeshkvinë e Kosovës: ekonom i Ipeshkvisë (2000-2016), dekan i Prishtinës (dy mandate: 2000-2007 dhe 2011-2016), drejtor i Radio Marisë Kosovë (2012-2014), drejtor i Fondacionit "Drita" për Kosovë (2013-2016).
Flet dhe e shkruan gjuhën shqipe dhe kroate, kurse e përdorë për komunikim gjuhën italiane.

Donatorët rinovuan Kishën Shën Ndou, Braticë

Pjeter Stanaj	$500.00	Braticë
Andrija Pepgjonoviq	$500.00	Ulqin
Mark Mirdita	$300.00	Pistull
Jozo Margjonoviq	$500.00	Krythë
Pal Daboviq	$100.00	Krythë
Pjeter Dobrecoviq	$100.00	Salç
Anto Barloviq	$200.00	Salç
Lukë Zefi Junkoviq	$200.00	Salç
Vinko Luka Jankoviq	$500.00	Salç
Andrija Markiq	$200.00	Kllezën
Rrok Jankoviq	$100.00	Kllezën
Mark Markaj	$100.00	Gjakovë
Stevo Pepgjonoviq	$100.00	Tivar
Mark Gazivoda	$100.00	Kodra Daka,Ulqin
Veton Gojani	$20.00	Kosovë
Gjergj Gazivoda	$100.00	Reç
Nik Gjokaj	$50.00	Dinoshë
Hil Zagreda	$100.00	Reç
Lek Çotaj	$100.00	Shën Gjergj
Mark Ndoci Zagreda	$50.00	Reç
Hila Çataliq	$50.00	Shtoj
Simë Zefi Markiq	$200.00	Kllezën
Luvigj Elezoviq	$100.00	Shtoj
Zef Paloka	$100.00	Kosovë
Kanto Deda Elezaj	$100.00	Shtoj
Palë Mirdita	$200.00	Kullomzë
Zef Markoviq	$200.00	Kullomzë
Gjon Markoviq	$200.00	Kullomzë
Lush Grabanica	$500.00	Kosovë
Marash Kola Dedvukaj	$100.00	Malësi
Luvigj Shkreli	$100.00	Amull
Lek Gjergj Zadrima	$200.00	Sutjel
Stjepë Nika	$200.00	Shqipni
Zef Simon Zadrima	$300.00	Sutjel
Tringe Shkreli	$100.00	Shën Gjergj
Zef Koloviq	$300.00	Salç
Leka Pjetrit Leks Lukiq	$100.00	Kullomzë
Preç Lukiq	$150.00	Salç
Gjergj Luvigj Markaj	$200.00	Kllezën
Gjon Luliqi	$100.00	Lulaj
Familja Ndoc Matis Gjonaj	$1,000.00	Reç
Florjan Gjergji	$100.00	Kosovë
Zef Marashi Junçaj	$50.00	Malësi
File Vasela Gjonaj	$50.00	?
Dom Nikolin Pergjini	$100.00	St.Lucy Bronx NY
Çesk Dojanaj	$100.00	Shkodër
Rrok Gjura	$40.00	Shqipëri
Arbën Shpijati	$20.00	Shqipëri
Paulin Shpijati	$20.00	Shqipëri
Paulin Gjini	$200.00	Shqipëri
Valentin Shkreli	$50.00	Amull, Ulqin
Nikë Boga	$100.00	Amull, Ulqin
Anton e Santina Nitaj	$100.00	?
Rrok Toma Dushaj	$100.00	?
Andrija Stanoviq	$400.00	Braticë
Zef Dobrecoviq	$500.00	Salç
Ndoca Mirdita	$300.00	Pistull
Djoko Lukiq	$200.00	Salç
Pavle Stanoviq	$300.	Braticë
Tom Filip Jankoviq	$100.00	Bruksel, Belgjikë
Kol Zagreda	$500.00	Reç
Pero Markoq	$200.00	Braticë
Vasil Koçaj	$100.00	Kllezën
Stevo P. Lukiq	$200.00	Kullomzë
Marko P. Lukiq	$200.00	Kullomzë
Pjerin Olivera Rroku	$50.00	Shqipëri
Marjan Vukel	$100.00	Shqipëri
Marjan Berishaj	$50.00	Malësi
Angel Junçaj	$20.00	Malësi
Nikoll Rroku Curanaj	$100.00	Guci
Maruka Ujkaj	$100.00	?
Gjergj Vuktilaj	$50.00	Shqipëri
Pashko Vuktilaj	$100.00	Shqipëri
Preng Vuktilaj	$50.00	Shqipëri
Pala Niks Hils Lukiq	$100.00	Salç
Andrija Pjetrit Leks Lukiq	$100.00	Kullomzë
Frankie & Prena Lukiq	$100.00	Kullomzë
Sandër Lelcaj	$20.00	Shqipëri
Pjetri Niks Margjonoviq	$200.00	Kullomzë
Nikoll Gjetja Curanaj	$100.00	Guci
Prek Frangaj	$100.00	Malësi
Mhill Velaj	$100.00	Kosovë
Fran Pllumaj	$100.00	Malësi
Simon Zefi Simon Lacaj	$300.00	Shën Gjergj
Vasel Nikolla Gjolaj	$100.00	Malësi
Zef Frani Camaj	$50.00	Malësi
Mark Shkreli	$200.00	Shën Gjergj
Margon Mrijaj	$50.00	Kosovë
Drane Curanaj	$40.00	Guci
Marjan Cubi	$100.00	Kosovë
Pal Nikollaj	$200.00	Kosovë
Gjergj Paloka	$100.00	Kosovë
Tush Musaj	$200.00	Kosovë
Zef Deda Rudaj	$100.00	Shtoj
Gjin Nikoll Berisha	$50.00	?
Rrok Pjetër Zadrima	$200.00	Zogaj?
Mrija Camaj	$20.00	Malësi
Vitore Dedvukaj	$20.00	Malësi
Tom N. Gojçaj	$40.00	Malësi
Hil N. Popaj	$100.00	Shën Gjergj
Gjuro Stanoviq	$100.00	Braticë
Aleks Bunjaj	$50.00	Shqipëri
Leonard Doçi	$50.00	Shqipëri
Jako Lukiq	$200.00	Kullomzë
Petar Koloviç	$100.00	Salç
Anton Hila Markiq	$300.00	Braticë
Mark Gjelaj	$50.00	Malësi
Vasil Kalaj	$50.00	Malësi
Pal Çotaj	$100.00	Shën Gjergj
Palok Nika Rudaj	$500.00	Shtoj
Pal e Stana Zegreda	$500.00	Reç
Nikoll Junçaj	$200.00	Malësi
Ylli Tinaj	$50.00	Malësi
Fran Çotaj	$100.00	Shën Gjergj
Ivo Mirdita	$200.00	Pistull
Ejllo Berishaj	$100.00	Malësi
Gjok Gjokaj	$50.00	Malësi
Mark Pashko Tinaj	$50.00	Malësi
Prel Sinishtaj	$50.00	Malësi
Loro Xhikoviq	$300.00	Braticë
Sandro Gjon Lula	$300.00	Ulqin
Anton Lec Popoviq	$600.00	Shën Gjergj
Stjepa Junkovq	$200.00	Salç
Andrija Niloviq	$200.00	Kullomzë
Daniel & Lisa Margjonoviq	$600.00	Braticë
Dragan P. Mardjonoviq	$500.00	Ulqin

Detroit Michigan

Rrok Sinishtaj	$100.00	Malësi
Ndue Duhani	$400.00	Kosovë
Marjan Gjetaj	$150.00	Kosovë
Don Nue Gjergji	$500.00	Kosovë
Gjergj Gjetaj	$200.00	Kosovë
Gjergj Ivezaj	$300.00	Malësi
Marash Nucullaj	$500.00	Malësi
Ndue Grabanica	$200.00	Kosovë
Kolë Marku	$200.00	Kosovë, Florida

Keshilli në New York

Zef Dobrecoviq, Vinko Jankoviq, Jozo Margjonoviq, Dragan Margjonoviq, Andrija Markiq, Andrija Pepgjonoviq, Pjeter Stanaj, Mark Mirdita

Kjo listë e donatorëve është lista e parë e atyre personave dhe familjeve që kanë dhanë donacion që nga data 15 Dhjetor 2015 deri më datën 10 Janar 2016, në New York dhe Michigan, si dhe një familje nga Florida.

Për pjesën organizative në New York i shkon një falënderim i veçantë Don Pjetër Popajt, famullitarit të Kishës shqiptare në New York, i cili në vorbullën e punës që ai ka çdo ditë, gjenë kohë për të organizua edhe për grumbullua ndihma për të gjithë ata që i trokasin në derë.

Natyrisht në numrin e ardhshëm të revistës do të botohen edhe emrat e donatorëve nga Chikago dhe nga vendet tjera si në USA, Australi dhe Evropë. Po ashtu do të botohen edhe emrat e familjeve vendore që kanë ndihmua. Dhe nëse ndonjë person apo familje ka mbetë pa u regjistrua në këtë listë, në do ti falënderojmë të gjithë ata që do të na japin sugjerime për këtë çështje, në mënyrë që në të ardhmen kur të publikohet lista definitive e donatorëve të mos na mbesë asnjë jashtë saje

Pjetër Dreshaj, model i arsimdhënies

Shkruan **Gjekë Gjonaj**

Kaherë e kam menduar dhe planifikuar të pasqyroj në media shqiptare portretin e këshilltarit tim të parë pedagogjik, profesorin e mirënjohur të gjuhës dhe letërsisë shqipe, Pjetër Dreshaj. Jo për arsye miqësie, e për t'i ngritur atij lavdi, por për meritën e tij të pakontestueshme në fushën e arsimit shqip.

I lumturuar nga lajmi se Komuna Urbane e Tuzit i ndau këtij profesori me formim të lartë, me përgatitje gjuhësore, me përvojë mësimdhënie, me kompetencë shumë profesionale dhe me aftësi drejtuese në profesionin e tij Çmimin për "Veprimtari Jetësore" për vitin 2015, po i shkruaj me përkushtim e respekt këto rreshta, në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për kontributin e tij vërtet të madh ndër vite të këtij misonari i cili, mendoj unë, e meriton " Kartën e Mësuesit".



Nga njohja ime shumëvjeçare me profesor Dreshajn më kanë mbetur në mendje e përherë të gjalla në kujtesën time këshilla, ndihma dhe mikëpritja në fshatin ku jeton, në Dreshaj, jo larg Tuzit. Gjithmonë pedant, siç i ka hije një punonjësi të mirëfilltë të arsimit. I etur për dituri. Njohës i mirë i gjuhës dhe i letërsisë shqipe.Pedagog i zoti. I aftë në mësuesi. Drejtues vizionar i shkollës. Njeri i qeshur. Komunikues. Pozitiv. I gatshëm për këshilla. I dashur dhe i afërt me nxënës, me prindër dhe me kolegë. Korrekt. I drejtë. Parimor e i përkushtuar në profesion.

Si mik i shtrenjtë dhe koleg i babait tim , të ndjerit Gjon, dhe dashamir i sinqertë i familjes tonë, ai më ka futur në rrugën e arsimit. Dashurinë dhe këmbënguljen për të mësuar sa më mirë gjuhën shqipe, ma nguliti edhe edhe mua në shpirt dhe zemër. Është meritë e tij që më bëri për vete për të vazhduar studimet në degën - gjuhë dhe letërsi shqipe, detyrë të cilën e ushtrova brenda viteve 1979 - 1986 në SHF " Gjergj Kastrioti- Skënderbeu" në vendlindjen time në Triesh. Punën time gjatë gjithë këtyre viteve me ditar në dorë e mbikqyri me kujdes dhe e vlerësoi me sukses profesori Dreshaj, asohere këshilltar pedagogjik për shkollat me mësim në gjuhën shqipe në Mal të Zi. Udhëzimet e tij që m'i dha për të kuptuar planin dhe programin mësimor , për të organizuar procesin mësimor, për t'u njohur me të rejat pedagogjike, për përdorimin e tyre në shkollë, për të zbatuar praktikën pedagogjike e shumëçka tjetër që është pjesë e mësimdhënies dhe e jetës në shkollë ishin me vlerë të madhe për mua.

Në fillimet e mia si mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe pasi përfundoi njëra nga orët e mësimit në sallën e arsimtarëve e pyeta profesor Dreshajn : "Më duket se nuk ju kënaqa", – i thashë disi i ndrojtur. "Jo – m'u përgjigj butësisht e me ngrohtësi. – Ti si gjithnjë tregove se ke një përgatitje të mirë mësimdhënieje dhe meritove vlerësimin tim të lartë, pavarësisht se je i ri në profesion". Sa m'u bë qejfi kur u shpreh kështu për mua! Kjo vërtet më inkurajoi për të vazhduar me më shumë pasion, dashuri e përkushtim profesionin e mësuesit.

Krahas këtyre dhe shumë kujtimeve të tjera, të cilat përherë do t'i ruaj në sirtaret e jetës sime me origjinalitetin e tyre, në bibliotekën time të vogël ruaj librat e tij të leximit për filloristët shqiptarë në Mal të Zi, disa nga përkthimet dhe nga shkrimet e tija të bukura dhe të kujdesshme tipik prej gjuhëtari, të cilat i ka botuar në shtypin e kohës. Por nuk arrita të siguroj asnjë raport (vlerësim) zyrtar të tij për punën time si mësimdhënës, për shkak të jotransparencës së shkollës.

Po ju kujtoj lexuesve se Pjetër Dreshaj ishte edhe folës dhe gazetar i mirë. Si fëmijë me kënaqësi e dëgjonim familjarisht zërin e tij të ëmbël dhe imponues në valët e Radio Titogradit të atëhershëm (sot Radioja e Malit të Zi), në emisonet shqip javore, njëorëshe, të marteve në ora 18 nëse nuk nuk kam harruar.

Dhe, në mbyllje, po shtoj se Pjetër Dreshaj e meriton të nderohet dhe vlerësohet portreti tij. Sepse ai me profesionin e tij përcolli gjithmonë dituri e kulturë tek nxënësit dhe mësimdhënësit shqiptarë në Mal të Zi. Për mua ishte dhe mbeti model i arsimdhënies. Karakteri i tij i madh njerëzor dhe ndershmëria e tij e pashoqe përbëjnë një shëmbëlltyrë frymëzuese dhe sfiduese për shoqërinë shqiptare. E për këtë atë dhe misionarët e tjerë të arsimit në Malësi dhe në troje të tjera tona etnike duhet që të vlerësohen dhe të nderohen.

“Flaka e Janarit 2016” në Gjilan

Poetët Basri Çapriqi e Halil Matoshi, fitues të Çmimit “Pena e Flakës”



Poetët Basri Çapriqi dhe Halil Matoshi e ndanë çmimin - Poezia më e mirë e lexuar në Orën e madhe letrare “Pena e Flakës 2016”, më 12.02.2016, aktivitet letrar që zhvillohet në kuadër të manifestimit “Flaka e Janarit 2016” në Gjilan, ku punimet e tyre i kanë lexuar krijues nga pjesë të ndryshme të Kosovës, Shqipëria, Maqedonia e Lugina e Preshevës.**“Pena e Flakës” iu kushtua shkrimtarit të shquar gjilanas, Beqir Musliut, në 20 vjetorin e shkuarjes së tij në amshim, që koincidoi edhe me 25 vjetorin e themelimit të këtij manifestimi.** Për të foli studiuesi dhe kritiku Prend Buzhala.

Pas Orës së madhe letrare u bë edhe shpallja e rezultateve të konkursit shpërblyes në poezi dhe prozë.

Juria e konkursit letrar “Flaka e janarit” 2016, në përbërje: Sinan Sadiku, Albina Idrizi dhe Aziz Mustafa, vlerësoi se konkursi letrar ishte tejet i suksesshëm.

Me këtë rast, anëtari i jurisë Sinan Sadiku tha se në konkurs kishin ardhur 81 poezi, rreth një e treta e të cilave me vlera të mirëfillta artistike, ndërsa gjysma e tyre janë veçuar në rrethin e ngushtë për shpërblime.

“Juria është e kënaqur me nivelin artistik të poezive dhe konsideron se ka prurje të reja edhe sa i përket gjuhës poetike, edhe sa i përket ritmit dhe ndërtimit të vargjeve e edhe sa u përket ideve, temave dhe shprehjes emocionale”, tha ai.

Sadiku ka thënë po ashtu se në konkurs kishin konkurruar krijues me 35 tregime.

“Vlerësojmë se është ruajtur niveli i viteve të kaluara edhe sa i përket sasisë e edhe sa i përket cilësisë”, tha ai.

“Flaka e janarit” është një manifestim letrar që tashmë ka krijuar një traditë të mirë duke tubuar shkrimtarë nga të gjitha trevat shqiptare, por edhe shkrimtarë të huaj si mysafirë të këtij manifestimi. **(Kohapress)**



Folklori jonë në festivale

Ansambli Shqiponja prej Malësisë së bashku me Ansamblin Trëndafilat e Shën Terezës prej Braticës, do të marrin pjesë në festivalin botëror të folklorit, që do të organizohet në Bullgari nga data 19 - 22 maj 2016.